ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **622-25-3344-2-2-1**
(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për: **Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për ndërtim,rinovim dhe legalizim sipas nevojave të DPMS-s**
(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Al Group PRO SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Sëiss Village nr,7
(Adresa)

Prishtinë **10000**
(Vendi) *(Kodi postar)*

04945 2222 _____
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Gezim Sylaj
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

algroup.pro.shpk@gmail.com
(Adresa elektronike)

30.06.2025 _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

SHOQËRIMI PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
AL GROUP PRO
PRISHTINË

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.
Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për kontrate i datës **22.04.2025**
- Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara-**12.05.2025**
- Data e dorezimit te tenderit **23.05.2025 14:00**
- Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues **16.06.2025**
- Kerkesa per rishqyrtim: **20.06.2025**
- Pergjigjia e kerkeses per rishqyrtim: **23.06.2025**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

Hapja na është dërguar përmes platëformes elektronike E-Prokurimi

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [ ] **Jo** [x]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [ ] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

- Zyra e Prokurimit e Autoritetit Kontraktues: Kuvendi Komunal i Prizrenit, me datën **16.06.2025** ka bërë publikimin e Njoftimit mbi vendimin e autoriteti kontraktues, Ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit, ndërsa me datën **20.06.2025** kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim, kërkesë e cila është refuzuar me daten **23.06.2025.**

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Neni 1 i LPP: Qëllimi

Neni 1 Siguron që objektivat e tenderit janë efikasë, transparencë, konkurrencë

- Neni 7 i LPP: Barazia në trajtim jo diskriminimi

Neni 7 Harton pjesëmarrjen pa barriera diskriminuese

- Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës

Neni 10 Përfshin klauzola për të mbështetur performancën (bonus, monitorim)

- Neni 28 Specifikimet teknike

Neni 28 Specifikime të qarta, neutrale, të bazuara në standarde

- Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes

Neni 51 Publikon qartë kriteret e vlerësimit në njoftim/dosje

- Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 56 Krijon procedura për verifikimin e kualifikimit dhe përzgjedhjes

- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 59 Zbaton procese formale për hapjen, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave

- Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimi

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimi

- Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Neni 65 Verifikon pranueshmërinë bazuar në kushte ligjore/financiare/teknike

- Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 69 Kërkon dhe vlerëson provat e kapaciteteve teknike/profesionale

- Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Neni 72.3 Kërkon informacion plotësues pa modifikim thelbësor të ofertave

- **Rregulloren 001/2022 për prokurimin publik në nenin 43**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te pa kënaqur me vendimin e date 23.06.2025 pas kerkeses per rishqyrtim ndaj AK KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për ndërtim,rinovim dhe legalizim sipas nevojave të DPMS-s me nr. te prokurimit: 622-25-3344-2-2-1 ne afatin ligjor konform ligjit, ushtrojmë këtë:

A N K E S Ë

Për shkak se AK- **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT , në mënyrë të kundërligjshme ka bërë Anulimin e Aktivitetit të prokurimit, për më shumë ne do të i shtjellojmë shkeljet në vijim:**

AK në vendimin e marrë ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit me pretendimin si në vijim:

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES –B 58

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:
"Hartimi I projekteve ideore dhe krzesore për ndërtim, rinovim dhe legalizim sipas nevojave të DPMS"

Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke:	**622-25-3344-5-2-1**
Numri i brendshëm Internal No Interni broj	

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës së çmimit të peshuar
1.	GOE: Studio Hapësira Sh.p.k, FST engineering Sh.p.k, Gjeo Projekt Sh.p.k	3.33
2.	GOE: Al group pro Sh.p.k, Semaks Sh.p.k, ZeroLine Sh.p.k	16.14

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Komuna Prizrenit e shpërblen me :
ANULOHET procedura prokuruese pasi që në paramasën e publikuar nga AK ka pozicione të cilat nuk janë të arsyeshme si në
- **Pozicionin A pika 2,3,4, dhe 5,**
- **Pozicioni B pika 3, dhe 7**
- **Pozicioni E, pozicioni F,**
- **Pozicioni G dhe**
- **Pozicioni H pika 2.**

Oxe
[shëno emrin e Autoritetit Kontraktues] **anulon**[1] aktivitetin e prokurimit *[Ne rast te anulimit te aktivitetit te prokurimit shëno arsyetimin për anulim]:*
Data>10.06.2025
Emri dhe mbiemri i ZDP: Isa Osmankaj

[1] Ketij formulari i bashkangjiten edhe letrat standarde te njoftimeve: B42, B45 dhe B46,(shtoni letra njoftuese sipas nevojes).
[2] Në rast të procedurave të kufizuara/procedurave konkurruese me negociata t'i bashkangjiten letrat standarde të

Pretendim i pa qëndrueshëm pasi që Sipas dispozitave të nenit 62 LPP-së thuhet qartë qe:

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:
1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.
2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:
2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo
2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Ku asnjëri nga këto pikat e specifikuar nuk qëndron, por anulimi i aktivitietit është një anulim i qëllimshëm nga ana e AK dhe komisionit të vlerësimit.

Gjithashtu edhe në Rregulloren 001/2022 për prokurimin publik në nenin 43 janë para te gjitha arsyet per anulimin e procedurës
43.5 Procedura e prokurimit *pas hapjes së ofertave* duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:
a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;
b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;
c. numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre);
d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;
f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
g. asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;
h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;
i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi
j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedures ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose
k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm

Asnjë nga këto arsye nuk qëndron. Për më tepër, me këtë sqarim në ankesën tonë, fakti i anulimit të qëllimshëm nga ana e Autoritetit Kontraktues dhe Komisionit të Vlerësimit vetëm sa konfirmohet dhe forcohet.

Nëse i analizojmë me kujdes të gjitha pikat e përmendura në ligj dhe rregullore, është e qartë se asnjë nga këto pika nuk e lejon anulimin e aktivitetit të prokurimit në këtë fazë.Pra thënë shkurt se anulimi ne këtë faze i aktivitetit te prokurimit për këto arsye qe i ka cekur AK është i kundërligjshëm dhe AK haptas po dëshiron që të na dëmtoj neve drejt për se drejti ne mënyrë te kundërligjshme e gjitha kjo pasi që kemi

ofruar tenderin e përgjegjshëm dhe një tender i cili ka përmbushur të gjitha kriteret në njoftimin për kontratë dhe Dosjen e tenderit. Komisioni i vlerësimit Komisioni i Vlerësimit, i përbërë nga z. Veron Aliu, Fari Krasniqi dhe Visar Ismajli, të cilët kanë ndërmarrë veprime në kundërshtim me dispozitat themelore të Ligjit për Prokurimin Publik (nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe i plotësuar me 05/L-068 dhe 05/L-092). ka shkelur në mënyrë të qëllimshme procedurat e prokurimit për të favorizuar operatorë ekonomikë specifikë Favorizimi ka rezultuar në trajtim të pabarabartë dhe ka cenuar konkurrencën e lirë midis operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Kjo sjellje cenon besimin në procesin e prokurimit publik dhe është në kundërshtim me parimet dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës.

Gjatë qasjes në dokumente zyrtare ne kemi kërkuar që të na ofrohen edhe komunikimet dhe sqarimet në lidhje se nnga kush ka ardhur vendimi që pozicionet janë të pa arsyshme një dokument i tillë nuk na është ofruar.

Gjatë gjithë procedurës nuk është paraqitur asnjë ankese për paramasë dhe parallogari por në pamundësi që të shpallet fitues operatori i preferuar te zyrtarit te prokurimit i cili nuk e ka plotësuar dokumentacionin dhe ka mbushur gabim paramasën dhe parallogarinë atëherë ka pretenduar se ka pozicione të paarsyshme.

Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Si dhe ne piken 2 te nenit 1 thuhet : *vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.*

AK ne mënyrë te kundërligjshme e ka anuluar këtë aktivitet te prokurimit dhe ne kundërshtim me nenin 62 te LPP-se dhe ne kundërshtim me nenin 43 te Rregullores për prokurim publik ku shume qarte janë te specifikuara kushtet se kur mundet te anulohet një procedure e prokurimit pas hapjes se ofertave.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga ana juaj si OSHP që të merr:

VENDIM

Aprovohet, si e bazuar Anksesa e kompanisë sonë.
Anulohet, njoftimi mbi anulimin e e Aktivitetit.
Lenda të kthehet në Rivlerësim, dhe gjatë rivleresimit, ekzaminimit, vleresimit dhe krahasimit të ofertave të bëhet siq e parashikon ligji nga profesionist të kësaj lëmie dhe rivlerësimi të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzimet mbi angazhimin ne përgatitjen,
Mundësia e konkurimit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"*
b) *Kërkesa për rishqyrtim*
c) *Vendimin e AK për kërkesën për rishqyrtim*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*